




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT  
PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR QËLLIME TË VEÇANTA PËR  
PROJEKTIN PËRKRAHJA PËR PËRMIRËSIMIN E  
HARTIMIT/ZHVILLIMIT TË POLITIKAVE NË KOSOVË  
PËR PERIUDHËN 1 JANAR 2021 DERI MË 31 DHJETOR 2021

Auditim në bazë të marrëveshjes me SIDA

Prishtinë, prill 2022

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit
- 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

Shtojca II: Letër konfirmimi

## 1 Opinioni i Auditimit

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore për Qëllime të Veçanta për projektin 'Përkrahja për përmirësimin e hartimit/zhvillimit të politikave në Kosovë' për periudhën 1 janar 2021 deri më 31 dhjetor 2021, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për qëllime të veçanta për periudhën audituese është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me raportin financiar.

Çështjet e ndërlidhura me raportimin menaxherial, kontrollet dhe zbatimin e rekomandimeve i kemi paraqitur në letër menaxhmenti të përgatitur krahas raportit të auditimit.

### 1.1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të projektit Përkrahja për përmirësimin e hartimit/zhvillimit të politikave në Kosovë

Auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare për qëllime të veçanta merr parasysh pajtueshmërinë me kërkesat për raportim konform marrëveshjes si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në pasqyra financiare.

#### Opinion i pamodifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat financiare për qëllime të veçanta të projektit të financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), për periudhën 1 janar 2021 deri më 31 dhjetor 2021, i cili përfshinë një përmbledhje burimit të fondeve dhe shpenzimeve e realizuara, pasqyrën e aplikimeve për tërheqjen e fondeve, dhe shpalosjet.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare për qëllime të veçanta ne lidhje me projektin Përkrahja për përmirësimin e hartimit/zhvillimit të politikave në Kosovë për periudhën 1 janar 2021 deri më 31 dhjetor 2021, paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat për raportim në marrëveshjen në mes të palëve, duke respektuar parimet kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

#### Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

#### Theksimi i Çështjes - Baza për kontabilitet

- 1 Ne tërheqim vëmendjen tuaj, për faktin që Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me kornizën për qëllime të veçanta, prandaj pasqyrat financiare nuk mund të përdoren për donjë qëllim tjetër.

Opiniononi jonë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje

### **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse**

Menaxhmenti i Zyrës së Kryeministrit (Njësia implementuese e projektit), është përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë dhe vërtetë të Pasqyrave Financiare për qëllime të veçanta, konform marrëveshjes së nënshkruar në mes të Qeverisë së Kosovës (përfaqësuar nga Zyra e Kryeministrit), përmes Sekretariatit Koordinues të Qeverisë dhe Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar. Mbështetja financiare e SIDA-së përbëhet nga dy pjesë: kontributi i drejtpërdrejt tek Qeveria (Thesar) si dhe pagesat për asistencë teknike. ZKM është përgjegjëse për mbajtjen e kontabilitetit si dhe për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare Vjetore.

Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Zyrës së Kryeministrit.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin**

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe Kornizën e Deklaratave Profesionale të INTOSAI (KDPI). Ky ligj dhe këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kritereve etike dhe ta planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq deklarime materiale.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për marrjen e dëshmive të auditimit lidhur me shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të keq deklarimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo të gabimit. Auditimi po ashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të kontabilitetit të përdorura, si dhe të arsyeshmërisë së vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Gjatë kryerjes së procedurës për vlerësimin e rrezikut, ne e marrim parasysh kontrollin e brendshëm përkatës në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit lidhur me efektshmërinë e tij. Sidoqoftë, ne do t'ju komunikojmë me shkrim për ndonjë mangësi të konsiderueshme në kontrollin e brendshëm që është relevante me auditimin e pasqyrave financiare të cilat i identifikojmë gjatë auditimit.

## 2 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) në bazë të marrëveshjes/kontratës me Agjencinë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), është përgjegjëse për kryerjen e auditimit financiar dhe pajtueshmërisë. Ky auditim përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare vjetore/raportit financiar vjetor dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse raporti financiar është në pajtim me Kërkesat e marrëveshjes së veçantë ndërmjet Qeverisë së Kosovës, përfaqësuar nga Zyra e Kryeministrit (ZKM/SKQ), si dhe Suedisë, përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA);
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm;
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit;
- Shqyrtojnë nëse bilanci mbyllës i periudhës paraprake është i njëjtë me bilancin hyrës të periudhës aktuale; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin si dhe detyrat shtesë sipas procedurave të dakorduara.

Metodologjia e auditimit është fokusuar në ekzaminimin e të dhënave dhe transaksioneve financiare, përfshirë dokumentacionin mbështetës. Ne kemi përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Sipas marrëveshjes së veçantë ndërmjet Qeverisë së Kosovës (ZKM) dhe Suedisë (SIDA) ndër tjera është përcaktuar se qeveria do të mirëmbajë një sistem të mirëfilltë të menaxhimit financiar për Projektin, në pajtim kjo me legjislacionin vendor ose me procedurat e tjera të dakorduara të aplikuara nga administrata publike. Po ashtu do t'i kryejë edhe do të jetë përgjegjëse për të gjitha prokurimet në kudër të Projektit në pajtim me rregullat, udhëzuesit dhe procedurat e saj të prokurimit.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit.

Në raport do të vendosen gjetjet që janë pjesë e opinionit për pasqyra financiare vjetore. Ndërsa gjetjet që kanë të bëjnë me aspektin e menaxhimit financiar, funksionimit të kontrollit të brendshëm dhe çështjet e pajtueshmërisë do të përmbliidhen në letër menaxhment si dhe gjetjet në bazë të procedurave të rena dakord.

### 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Ne i kemi shqyrtuar shpenzimet e fondeve sipas linjave buxhetore. Kjo është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

#### 3.1 Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Sistemi financiar dhe kontrollet mbi shpenzimet në përgjithësi janë të mira, megjithëse menaxhimi i shpenzimeve për praktikant është përcjellë me dobësi, por pa ndonjë ndikim material, e cila është trajtuar në letër menaxhment. Ndërsa sa i përket procedurave të rëna dakord nuk kemi indentifikuar ndonjë mangësi.

#### 3.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Në vitin 2021 OB ka shpenzuar 26.55% të buxhetit përfundimtar ose € 39,912.05, me një ulje prej rreth 12% në krahasim me vitin 2020. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të pakënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

**Tabela 1. Shpenzimet sipas linjave buxhetore të SIDA-as (në €) - shifrat e rrumbullakuara**

Përshkrimi	Buxheti planifikuar	2021 Realizimi	2020 Realizimi	2019 Realizimi
<b>Llojet e shpenzimeve/totali</b>	<b>150,335</b>	<b>39,912</b>	<b>97,429</b>	<b>246,847</b>
Pagesa për praktikant	20,000	20,000	29,750	26,000
Vizita studimore në Suedi	0	0	0	43,794
Vizita studimore në Belgjikë	0	0	0	0
Pajisje për zyrë	7,000	9,079	300	712
Shpenzimet e përkthimit	0	0	4,418	24,375
Shpenzimet e takimit	13,988	1,214	51,278	30,155
Socializimi (Team building)	3,000	0	0	625
Trajnimet (përfshirë edhe trajnimet nga 2020)	73,347	1,667	11,683	78,962
Bashkëpunimi regjional	0	0	0	14,943
Auditimi vjetor (viti 2021 dhe 2022)	6,000	2,940	0	2,730
Vlerësimi afatmesëm i projektit	0	0	0	19,218
IKAP	0	0	0	3,868
Mbështetje për konsultim	27,000	5,012	0	1,465

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë: (Përshkrimet të

renditen konform radhitjes në tabelën e mësipërme)

Në vitin 2021 OB ka shpenzuar 26.55% të buxhetit përfundimtar ose € 39,912.05, me një ulje prej rreth 12% në krahasim me vitin 2020. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të pakënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

- Buxheti për Angazhimin për praktikant ishte realizuar 100%;
- Buxheti për pajisje për zyrë nuk është shpenzuar fare, pasi që shumica e pajisjeve të nevojshme janë siguruar viteve të kaluara;
- Buxheti për shpenzime të takimeve është shpenzuar vetëm 7% e buxhetit të planifikuar;
- Buxheti për shpenzime të trajnimeve duke përfshirë edhe trajnimet e vitit 2020 është realizuar vetëm 2% e buxhetit të planifikuar;
- Buxheti për shpenzime të auditimit vjetor (viti 2021-2022) për vitin 2021 është shpenzuar 49% e buxhetit të realizuar;
- Buxheti për shpenzime të socializmit nuk është shpenzuar fare;
- Buxheti për realizim të trajnimeve është realizuar vetëm 1%;
- Buxheti për mbështetje e konsultim/punëtori është realizuar vetëm 18%.

Bezad Halilaj, Zëvendës Auditor i Përgjithshëm



Naser Arllati, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Jusuf Kryeziu, Udhëheqës i Auditimit



Refiqe Morina, Udhëheqëse e ekipit



Fatlinda Podvorica, Anëtare e ekipit







REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT	
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister	
Sekretari i Përgjithshëm - Generalni Sekretar - Secretary General	
Numri: 02	Prillogje: 604/2
Titulli: - 1 -	Data: 19 / 04 / 20 22
Tirane	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister**  
**Sekretari i Përgjithshëm - Generalni Sekretar - Secretary General**

Datë: 19.04.2022  
Ref: 095/2022

## LETËR KONFIRMIM

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

**Për:** Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin dhe letër menaxhmentin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Projektit "Përkrahja për përmirësimin e hartimit/zhvillimit të politikave në Kosovë", për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti dhe letër menaxhmenti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit,
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do të ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Me respekt,

**Arben Krasniqi**

Zv. Sekretar i Përgjithshëm



## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

**Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit**

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

